

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 74/2014 “PËR ARMËT”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi kryesor i hartimit të këtij projektligji, në përputhje dhe me objektivin nr. 1 të Strategjisë për kontrollin e AVL 2019-2024, përcakton që brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.

Hartimi i këtij projektligji është diktuar nga nevoja për të rregulluar çështjet në lidhje me:

- kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të armëve të kategorive të përcaktuara, sipas këtij ligji;
- marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe subjekteve për pajisjen me armë e municione, kur një e drejtë e tillë ka lindur për shkak të pronësisë apo të detyrës;
- marrëdhëniet për lëshimin e licencave dhe autorizimeve nga Policia e Shtetit për çdo subjekt të interesuar për veprimtaritë e lejuara me armë, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj;
- veprimtarinë e prodhimit, çaktivizimit dhe riparimit të armëve.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të këtij projektligji janë:

- a) përafrimi i ligjit ekzistues 74/2014, “Për armët” me legjislacionin e Bashkimit European, përkatësisht me Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017 që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991 “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”.
- b) përmirësimi i kushteve dhe kriterëve për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, çaktivizimin dhe gjurmimin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve për përdorim civil.
- c) njësimi i plotë i termave (përkufizimeve dhe kategorive të armëve, pjesëve të armëve dhe municioneve), objekt i ligjit nr. 74/2014, me legjislacionin e Bashkimit European.

- d) përcaktimi i kategorive të armëve, të cilat nuk lejohen të përdoren nga personat fizik dhe juridik (civil) dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim.
- e) përcaktimi i kategorive të armëve, të cilat lejohen të përdoren nga personat fizik dhe juridik (civil).
- f) përmirësimi i markimit të armëve të importuara me qëllim gjurmimin e tyre.
- g) regjistrimi i armëve, pjesëve dhe municioneve me qëllim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit brenda vendit dhe me anëtarët e BE.
- h) ndryshime me qëllim përmirësimin dhe forcimin e masave për dhënien e lejeve dhe licencave.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2020.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Risitë e këtij projektligji kanë të bëjnë me objektin dhe fushën e veprimit, përkufizime, kategorizime, kritere etj., të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në ligjin nr. 74, datë 10.07.2014 “Për armët”.

Duke vlerësuar se lufta kundër krimit dhe përmirësimi i rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri, janë dhe mbeten prioritetet strategjike për Qeverinë e Shqipërisë, se armët e zjarrit dhe municionet luftarake pa leje në duart e qytetarëve, vijojnë të jenë burim i rrezikut serioz për jetën e qytetarëve, për rendin dhe sigurinë publike, edhe si një pengesë serioze për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Policia e Shtetit në vazhdimësi i ka kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit të veprave penale të armëmbajtjes pa leje, por edhe të veprave të tjera penale që kanë të bëjnë me trafikimin e armëve, të municioneve etj.

Vendi ynë ka përqaftuar iniciativat rajonale për forcimin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL), në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë rajonin.

Strategjia për kontrollin e AVLE 2019-2024 dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Kontrollin e AVL 2019-2021, e miratuar me vendimin nr. 50 datë 06.02.2019, të Këshillit të Ministrave, në përputhje me fushat e përgjegjësisë dhe bazuar në një

vlerësim të plotë të situatës së kontrollit të armëve në Shqipëri, siguron dhe monitoron përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë, sipas marrëveshjeve dhe dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve.

Objektivat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë në përputhje të plotë me Udhërrëfyesin për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre, në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024.

Armët e Vogla dhe të Lehta, nëse nuk kontrollohen, mund të paraqesin kërcënim për sigurinë e brendshme dhe vendi të klasifikohet si vend tranzit, apo burim i rreziqeve për rajonin dhe Bashkimin Evropian. Armët ndikojnë tek njerëzit, komunitetet dhe bizneset. Ato vazhdojnë të shkaktojnë humbje të jetëve, dëme ekonomike dhe sociale, si dhe frikë për publikun.

Edhe pse vendi ynë ka një ligj në fuqi për armët, miratimi për herë të parë të pronësisë private mbi armët, ka nevojë për ndryshime, jo vetëm për shkak të eksperiencës së krijuar gjatë zbatimit të tij, por edhe për faktin se Direktiva e Armëve të Zjarrit të BE-së ka ndryshuar në vitin 2017.

Ministria e Brendshme është përgjegjëse për propozimin, hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e armëve dhe eksplozivëve.

Policia e Shtetit është institucioni kryesor i ngarkuar me luftën kundër trafikeve të paligjshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve, në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese për parandalimin dhe zbulimin e trafikeve të paligjshme në kufi dhe brenda territorit të vendit. Policia Shtetit jep licensat dhe autorizimet për veprimtaritë e lejuara me armë, për personat fizik dhe juridik, në përputhje me legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar, si dhe ushtron kontrollet në Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe personat e tjerë fizikë e juridikë, të autorizuar apo licensuar për të mbajtur armë mbi kushtet e sigurisë së mbajtjes së armëve.

Objektivi 1 i Strategjisë, përcakton që brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.

Një nga aktivitetet në kuadër të këtij objektivi është rishikimi i vazhdueshëm i legjislacionit dhe politikave dhe sinkronizimi me ndryshimet ligjore të BE-së, në veçanti adaptimi dhe plotësimi i ligjit “Për Armët” dhe aktet nënligjore, në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së për Armët e Zjarrit dhe Rregulloren për Çaktivizimin e Armëve.

Sa sipër, nisur nga detyrat dhe objektivat e përcaktuara në vendimin nr. 50, të Këshillit të Ministrave, si dhe në problematikat e ndeshura në zbatim nga komisaritet e policisë, në veçanti për lëshimin apo revokimin e lejeve për mbajtjen e armëve, u ngrit grupi i punës me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 399, datë 10.05.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për Armët”.

Ndryshimet në legjislacionin e Bashkimit Evropian, përkatësisht me Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017 që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, "Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve" me synim përafrimin e ligjit ekzistues, bënë të domosdoshëm ndryshimet në ligjin 74/2014, "Për Armët".

Disa nga çështjet që lindi nevoja për rregullim dhe ndryshim janë:

- Domosdoshmëria e forcimit të masave për dhënien e lejeve e licencave e autorizimeve për veprimtaritë me armët;
- Përmirësimi i sistemit të administrimit dhe regjistrimit të armëve në përdorim të personave fizik dhe juridik;
- Kërkesa për shkëmbim informacioni me vendet e BE për armë të humbura e të trafikuar.

Miratimi i këtij projektakti do të ketë impakte pozitive në drejtim të kufizimit të armëve të trafikuar, në administrimin e armëve (regjistrimin), gjurmimin dhe kufizimin e përdorimit të armëve të pa ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në hartimin e ndryshimeve në ligjin 74/2014, grupi i punës punoi për harmonizimin me kuadrin ligjor të BE-së, duke u bazuar në ndryshimet më të reja të legjislacionit për armët në Bashkimin Evropian.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët” është hartuar në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës, si dhe në harmoni me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të vendeve të BE-së.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj synon përafrimin *acquis* të BE-së. Për këtë arsye, ai është përafruar pjesërisht me direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991 "Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve", e ndryshuar me direktivën 2008/51/KE, nr. 179, datë 8 korrik 2008; Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017, që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, "Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve". Gjithashtu projektligji ka përafrim të pjesshëm dhe me Rregulloren dhe nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 mars 2012, në zbatim të nenit 10 të protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse të tyre dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe që vendos masat për autorizimin e importit, eksportit dhe transitit të armëve të zjarrit, pjesë përbërëse të tyre dhe municioneve.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji parashikon 35 nene, të përmbledhura si më poshtë:

Në nenin 1 të projektligjit, bëhen ndryshime në nenin 1 të ligjit nr. 74/2014, "Për Armët", ku më konkretisht ndryshohen kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, çaktivizimin, importimin, gjurmimin e transportimin, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të armëve, pjesëve kryesore e municioneve për përdorim civil, sipas këtij ligji, ndërsa shfuqizohen marrëdhëniet për lëshimin e licencave dhe autorizimeve nga Policia e Shtetit për çdo subjekt të interesuar për veprimtaritë e lejuara me armë, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 2 të projektligjit, ndryshohet neni 2 i ligjit ekzistues, me qëllim riformulimin me të saktë në lidhje me referimin në bazën ligjore për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe për municionet dedikuar për nevoja të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3, ndryshohet me qëllim përfshirjen e përkufizimeve të reja për armët dhe kategoritë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Me nenin 4 bëhen disa ndryshime në dispozitën përkatëse të ligjit aktual, në lidhje me kategorizimin e armëve, duke shtuar edhe kategori të reja dhe specifikimet e tyre përkatëse.

Neni 5 parashikon ndryshim në lidhje me parashikimin e pikës 1 të nenit 7 mbi të drejtën e pronësisë mbi armët, konkretisht armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, të cilët janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit për qëllime të shërbimeve të sigurisë, koleksionit, muzeut.

Gjithashtu, neni 5 i projektligjit heq armët e parashikuara sipas kategorisë “D” në pikën 2, të nenit 7 të ligjit aktual.

Neni 6 i projektligjit bën disa shtesa e ndryshime në nenin 8 të ligjit në fuqi, që lidhet me regjimin juridik për kategoritë e armëve.

Në nenin 7 parashikon një shtesë në nenin 8 të ligjit, konkretisht neni 8/1, i cili përcakton kriteret për blerjen e armës nga personi fizik dhe juridik.

Neni 8 i projektligjit parashikon se në nenin 9, pas pikës 7 të ligjit 74/2014, "Për Armët", të shtohen pikat 8, 9 dhe 10 me përmbajtje në lidhje me markimin e dukshëm, të përhershëm dhe unik të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të importuara nga Bashkimi Evropian, duke përfshirë të dhënat e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe vitin e prodhimit.

Neni 9 parashikon ndryshimin dhe shtimin e parashikimeve të reja, në lidhje me regjistrimin e armës së zjarrit, të cilat përfshijnë të dhënat personale përkatëse të ruajtura në sistemet e ruajtjes së të dhënave nga autoritetet kompetente për një periudhë kohore të përcaktuar. Këto të dhëna mund të aksesohen dhe nga autoritete kompetente për lëshimin ose revokimin e autorizimeve të licensave, apo nga autoritete për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale. Në këtë nen parashikohet dhe mundësia e fshirjes së të dhënave nga sistemi i ruajtjes së tyre, pas përfundimeve të periudhave të specifikuara shprehimisht në këtë nen. Gjithashtu, shtohet parashikimi për mënyrën e procedimit të regjistrimit të armës nga ana e tregtarëve dhe detyrimi i tyre për të raportuar organet përgjegjëse të policisë.

Në nenin 10, pas veprimtarive të lejuara për armët, të parashikuara në nenin 12 të ligjit aktual, shtohen edhe veprimtaritë për ndërmjetësimin dhe transitin.

Neni 11 ndryshon formulimin e nenit 13, ku përcaktohen masat për licensimin e veprimtarive të lejuara me armë, duke shtuar kontrollin e integritetit profesional dhe privat të personave fizik apo juridik.

Në neni 12 bëhen disa shtesa dhe ndryshime, për të saktësuar llojet e licensave për pajisjen me armë, si dhe strukturën përgjegjëse që i lëshon, bazuar në kategorizimin e tyre.

Neni 13 shfuqizon neni 15 të ligjit aktual mbi licenca për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive të përcaktuara sipas këtij ligjit.

Neni 14 përcakton ndryshime në titullin e nenit 16 të ligjit dhe pikës 1 të tij, si dhe heq përcaktimin e kategorive të caktuara, në dhënien e licencës për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre.

Neni 15 bën disa ndryshime në titull dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 17 të ligjit, si dhe formulimin e pikës 3 me qëllim kufizimin e kategorive të mbajtjes dhe përdorimit të armëve në poligonin civil të qitjes, ndërsa në poligonin civil të qitjes me pjatell, lejohet vetëm mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut.

Në nenin 16 të projektligjit, shtohen dy nene të reja, konkretisht neni 18/1 dhe 18/2, të cilat përcaktojnë llojet e licencave, si licenca për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive, licenca për poligon civil qitje, licenca për aftësim teorik e praktik, licenca për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil, licenca për import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.

Neni 17 përcakton ndryshime në nenin 19 për kriteret e përgjithshme të licencimit, duke shtuar një pikë të veçantë në lidhje me kriteret për licencat e parashikuara për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil, dhe import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.

Në nenin 18 të projektligjit, janë shtuar nene të reja, konkretisht neni 19/1, 19/2, 19/3 dhe 19/4, në lidhje me procedurat dhe kontrollin e importit, autorizimin e importit, transferimin e përkohshëm të armëve dhe municioneve të tyre, si dhe transiti i mallrave armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre.

Në nenin 19, ndryshohen dispozitat e nenit 23 të ligjit aktual, mbi veprimtarinë e personave fizik apo juridik, të licensuar/autorizuar nga organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit, të cilët duhet ti nënshtrohen inspektimit të rregullt nga këto organe, mbikqyrjes së përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit, përfshirë masat e sigurisë për shitjen dhe blerjen e armëve, si dhe pajisjen me dëshminë e aftësisë teorik dhe praktik të armëve.

Neni 20 shfuqizon autorizim për rimbushjen e municioneve dhe autorizim për mbajtjen e armës së ftohtë në vendbanim.

Në nenin 21, ndryshohet formulimi i nenit 25 të ligjit, duke hequr përcaktimin sipas katëgorive të armëve, për pajisjen me autorizim për blerje arme zjarri e municione përkatëse të personave juridik.

Në nenin 22 të projektligjit, ndryshohet neni 26 i ligjit aktual, në lidhje me autorizimin për blerje arme të personave fizikë, duke shtuar qitësit sportive dhe gjuetarët, si dhe duke shfuqizuar kategorinë e personave fizikë që plotësojnë kriteret për pajisjen me autorizim, sipas nenit 34 të ligjit aktual.

Neni 23, parashikon shtimin e dy pikave të reja në nenin 27 të ligjit, konkretisht në lidhje me ndalimin e autorizimit për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe lëvizje, për armët me alarm e sinjalizim me dritë, armëve pneumatike (ajrore), armëve të ftohta dhe paralizuesit elektrikë. Gjithashtu përcaktohet e drejta e ish-punonjësve të Policisë së Shtetit, që me ligj kanë në pronësi private armë zjarri, për të lejuar mbajtjen e armës në lëvizje.

Neni 24 parashikon shfuqizimin e nenit 29 të ligjit aktual, mbi autorizimin për mbajtjen e armëve të ftohta nga organi përgjegjës.

Në nenin 25 parashikohet shtimi i një paragrafi të ri, mbi autorizimet për përdorim skenik, kinematografik dhe për koleksionim armësh, të kategorive të armëve “A”, “B” dhe “C”, kundrejt tarifës dhe autorizimit të Policisë së Shtetit.

Neni 26 parashikon shfuqizimin e nenit 33 të ligjit aktual, në lidhje me autorizimin për rimbushjen municioneve.

Në nenin 27, bëhen ndryshime dhe saktësime në lidhje me kriteret e personit që është përfitues i një prej llojeve të autorizimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe shfuqizon pikën ku parashikohet se çdo person ka të drejtë të pajiset me armë gjahu dhe koleksionit me jo më shumë se tri autorizime të të njëjtit lloj, ose jo më shumë se pesë autorizime të armëve të llojeve të ndryshme.

Neni 28 parashikon përjashtimin e punonjësit aktiv të strukturave shtetërore të armatosura, për të dëshmuar gjendjen e shëndetit mendor në raportin mjekësor, për blerjen/mbajtjen e një arme, si dhe ndryshohet afati i vlefshmërisë së këtij raporti, nga 3 muaj, në 6 muaj.

Neni 29, bën një riformulim të nenit 38 të ligjit aktual, në lidhje me lëshimin e autorizimit për blerje dhe për mbajtje arme, që përfshihen në kategoritë “B” dhe “C”, duke eliminuar kategorinë “D”, si dhe përcakton personat fizikë që për nevoja të gjuetisë kanë të drejtë të pajisen me armë gjahu sipas përcaktimeve specifike.

Në nenin 30 të projektligjit, bëhen disa ndryshime në nenin mbi tjetërsimin në kushtet e përdorimit vetjak të armës, duke shtuar parashikime të reja në lidhje me: subjektet e licensuara për tregtim që u lejohet të shesin armët e zjarrit, pjesët e armës dhe



municioneve, vetëm personave juridik dhe personave fizik të pajisur me autorizim të vlefshëm nga organi përgjegjës i policisë; transferimin e mëtejshëm të armëve të zjarrit të kategorive “C”, i cili i bëhet vetëm personave të pajisur me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës; shitja e armës së zjarrit midis subjekteve fizik/juridik të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licence dhe subjekteve me autorizim për blerje arme, bëhet me kontratë të vërtetuar tek noteri, e cila duhet të përmbajë të dhënat e sakta të armës; blerja e shitja e armëve të gjahut të kategorisë “C”, e cila lejohet vetëm me autorizim brenda ose jashtë vendit; ndalimi i shitblerjes së armëve, pjesëve të armës dhe municionit përmes internetit, etj.

Neni 31 bën disa përcaktime në lidhje me nenin 40 të ligjit aktual, mbi mbajtjen e armës nga autoritetet e huaja, ku shtohen punonjësit e misioneve policore të huaja, për zhvillimin e operacioneve të përbashkëta me Policinë e Shtetit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 32 parashikon ndryshime në nenin 41, konkretisht ndryshimin e pikës 5 të këtij neni, si dhe shtimin e pikave 5.1, 5.2 dhe 5.3, të cilat parashikojnë rregullat dhe përgjegjësinë për ruajtjen, përdorimin dhe raportimin, për armët e zjarrit dhe municionet.

Neni 33, parashikon ndryshime në nenin 43 të ligjit, duke përcaktuar se armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe ato të grumbulluara me ligj nga Policia e Shtetit të gjetura në ambiente, armët stok nga ristrukturimi i armatimit të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Informativ Shtetëror, apo hotspotet nga strukturat e Forcave të Armatosura, i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes me urdhër të përbashkët për kalim kapital. Gjithashtu po në këtë nen shtohen pikat 2.1 dhe 2.2 mbi procedurat të demilitarizimit, asgjësimit të tyre dhe shitjes për skrap nga ministria përkatëse.

Neni 34, parashikon shtimin e neni 56/1 mbi kompetencat e dhënies së masave administrative.

Neni 35, parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

Bashkëlidhur këtij relacioni dhe pjesë e tij, është dhe tabela e përputhshmërisë me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, sipas direktiva të përmendura më sipër në rubrikën përkatëse të relacionit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, institucionet e tjera që në bazë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi kanë detyrime, si dhe të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë veprimtarinë e lejuar me armët.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr. 399, datë 10.05.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për Armët”.

Në mbledhjet e grupit të punës, me qëllim diskutimin e problematikave teknike të konstatuara gjatë hartimit të draftit, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, konkretisht nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji paraqet efekte financiare shtesë për Buxhetin e Shtetit.

Kosto fillestare nga buxheti i shtetit për regjistrimin e armëve në pronësi të shtetasve është 55 (pesëdhjetë e pesë) milion lekë për prodhimin e autorizimeve digjitale për mbajtjen e armëve. Parashikuar 100,000 (njëqind mijë) copë me kosto 550 (pesëqind e pesëdhjetë) lekë për njësi.

Përfitimi i mundshëm nga regjistrimi do të jetë 200 (dyqind) milion lekë. Duke parashikuar pajisjen e 100,000 shtetasve me autorizime digjitale me kosto 2,000 (dy mijë) lekë për njësi.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**SANDËR LLESHAJ**